



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE**  
**УСТАВНИ СУД**  
**CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 3 nëntor 2014  
Nr. ref.: RK716/14

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**Rastin Nr. KI83/14**

Parashtrues

**Sahit Rakaj**

**Kërkesë për vlerësimin e Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës  
Supreme të Kosovës, Rev. nr. 188/2013, të 7 nëntorit 2013**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar  
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare,  
Kadri Kryeziu, gjyqtar dhe  
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Parashtrues i kërkesës është z. Sahit Rakaj nga fshati Vërmicë, komuna e Prizrenit.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Vendimi i kontestuar nga parashtruesi është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme), Rev. nr. 188/2013, i 7 nëntorit 2013, të cilin parashtruesi e ka pranuar më 28 prill 2014.

## **Objekti i çështjes**

3. Objekt i çështjes së kësaj kërkesë është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 188/2013, të 7 nëntorit 2013, me të cilin parashtruesi i kërkesës pretendon se i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenet: 3 dhe 24 [Barazia para Ligjit]; nenin 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare]; nenin 23 [Dinjiteti i Njeriut]; si dhe nenin 49 [E Drejta në Punë dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

## **Baza juridike**

4. Baza juridike e kërkesës është: neni 113.7 i Kushtetutës, neni 20 dhe 47 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji)

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

5. Më 12 maj 2014, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 10 qershor 2014, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin GJR. KI83/14 caktoi gjyqtarin Kadri Kryeziu gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, me Vendimin KSH. KI83/14, Kryetari caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Ivan Čukalović.
7. Më 10 qershor 2014, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës dhe informoi Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës.
8. Më 15 shtator 2014, me vendim të Kryetarit, gjyqtari Robert Carolan u zëvendësua me gjyqtarin Altay Suroy si kryesues i Kolegjit shqyrtues.
9. Më 23 shtator 2014, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

## **Përmbledhja e fakteve**

10. Më 30 gusht 2010, parashtruesi i kërkesës lidhi kontratë pune në kohë të caktuar me Komunën e Prizrenit-Drejtoria për Arsim dhe Shkencë (DASH), në kohëzgjatje prej 1 shtator 2010 deri më 31 gusht 2011, për mësimdhënie në lëndën e Biologjisë dhe Mbrojtje të Ambientit, në dy paralelet e ndara të gjimnazit "Remzi Ademaj" në Prizren.
11. Më 19 tetor 2011, parashtruesi ka paraqitur ankesë në DASH të Komunës së Prizrenit, meqë kontrata e punës nuk i ishte vazhduar.

12. Më 9 nëntor 2011, DASH refuzoi ankesën e parashtruesit, për faktin se parashtruesi, paraprakisht është dashur të parashtroi ankesë në shkollën ku ai ka punuar, duke e arsyetuar refuzimin e ankesës se shkolla ku ai ka punuar e dinë më mirë gjendjen reale se përse parashtruesi ka mbetur pa orë të mësimi nga shtatori i vitit 2011.
13. Më 21 nëntor 2011, parashtruesi ka ushtruar padi në Gjykatën Komunale në Prizren, duke kërkuar që kjo gjykatë të konstatojë se mosvazhdimi i kontratës së punës është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi dhe duke kërkuar që gjykata ta detyrojë DASH-Prizren, që parashtruesin ta kthejë në punë si mësimdhënës në vendin e punës ku ai ka punuar.
14. Më 6 qershor 2012, Gjykata Komunale në Prizren (Aktgjykimi, C. nr. 795/11), aprovoj si të bazuar kërkesëpadinë e parashtruesit, duke konstatuar se mosvazhdimi i kontratës së punës së tij është në kundërshtim me ligjin për arsim dhe ligjin e punës dhe e obligoj Komunën e Prizrenit që parashtruesin ta kthejë në vendin e punës ku kishte punuar para se kontrata të mos i vazhdohej.
15. Në arsyetimin e këtij aktgjykimi në mes tjerash gjykata komunale ka konstatuar: *“Si përfundim, gjykata vlerëson se e paditura Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, ka bërë shkelje të dispozitave ligjore të parapara me nenet 71.2, 72.1 dhe 72.2 të Ligjit të Punës, me rastin e mos vazhimit të kontratës së punës së paditësit, andaj vendosi që kërkesëpadinë e paditësit ta aprovoj në tërësi si të bazuar në ligj dhe në fakte”.*
16. Më 14 mars 2013, Gjykata e Apelit, duke vendosur sipas ankesës së avokatit publik të Komunës së Prizrenit, nxori Aktgjykimin CA. nr. 3650/2012, me të cilin miratoi ankesën e Komunës së Prizrenit, duke ndryshuar Aktgjykimin e Gjykatës Komunale të Prizrenit, C. nr. 795/2011 të 6 qershorit 2012 ashtu që padinë e parashtruesit e refuzoi si të pabazuar.
17. Në arsyetimin e aktgjykimit të saj Gjykata e Apelit kishte theksuar: *“Duke shqyrtuar aktgjykimin e atakuar kjo gjykatë gjeti se në mënyrë të bazuar tregohet me ankesë se aktgjykimi i shkallës së parë është përfshirë me shkelje thelbësore të LPK-së dhe atë të nenit 182 paragrafi 2 pika n). Me fjalë tjera, dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar është i palogjikshëm dhe i njëjti është në kundërshtim me vetveten si dhe me arsyet e fakteve vendimtare të dhëna në arsyetim”.*
18. Gjykata e Apelit, për më tepër, arsyeton aktgjykimin duke theksuar se: *“gjendja faktike është vërtetuar drejt dhe në masë të mjaftueshme, por në një gjendje të këtillë të vërtetuar, është zbatuar gabimisht e drejta materiale”* dhe se *“neni 67 i Ligjit të punës parasheh që kontrata e punës ndërpritet sipas vetë ligjit ndër të tjera edhe me kalimin e kohës për të cilën është lidhur kontrata”.*
19. Më 7 nëntor 2013, Gjykata Supreme e Kosovës, duke vendosur sipas kërkesës së parashtruesit për revizion, nxori Aktgjykimin Rev. nr. 188/2013, me të cilin në pikën I të dispozitivit e refuzoi si të pabazuar revizionin e paraqitur nga parashtruesi në pjesën që i referohet kthimit të tij në vendin e punës ku kishte punuar, ose të sistemohej në ndonjë vend tjetër të punës që i përgjigjet përgatitjes së tij profesionale, dhe në pikën II aprovoj revizionin e parashtruesit

në pjesën që i referohet pagesës së një page mujore duke e detyruar Komunën e Prizrenit-DASH, që parashtruesit t'ia paguaj një pagë mujore që ai e ka realizuar sipas kontratës së punës.

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

20. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme shkel të drejtat kushtetuese të garantuara me nenet: 3 dhe 24 [Barazia para Ligjit]; nenin 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare]; nenin 23 [Dinjiteti i Njeriut]; si dhe nenin 49 [E Drejta në Punë dhe Ushtrimit të Profesionit], duke pretenduar se Gjykata Supreme aktgjykimin e ka bazuar në *"institutin e skadimit të kontratës së punës"* edhe pse të gjithë të punësuarit tjerë kanë pasur status të njëjtë të punësimit por atyre u është vazhduar kontrata e punës.
21. Parashtruesi ka përmendur në kërkesë edhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut [KEDNJ] por pa specifikuar konkretisht shkeljen e ndonjë të drejte të mbrojtur me këtë konventë.

### **Pranueshmëria e kërkesës**

22. Për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit, Gjykata paraprakisht vlerëson nëse pala i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të parapara me Kushtetutë, dhe të specifikuar më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
23. Përkritazi me këtë, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës që përcakton:  
*"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj"*.
24. Lidhur me si më sipër Gjykata konstaton se parashtruesi është palë e autorizuar sipas nenit 113.7 të Kushtetutës, se ka shterur mjetet juridike të parapara me ligj dhe se kërkesën e ka dorëzuar në Gjykatë brenda afatit prej 4 (katër) muajve të paraparë me nenin 49 të Ligjit...
25. Duke vlerësuar pretendimet e parashtruesit për shkeljet e Kushtetutës, Gjykata konstaton se dispozitat kushtetuese, shkelja e të cilave pretendohet, kanë këtë përmbajtje:

Neni 3 paragrafi 2 [ Barazia para Ligjit]

*"Ushtrimi i autoritetit publik në Republikën e Kosovës bazohet në parimet e barazisë para ligjit të të gjithë individëve dhe në respektimin e plotë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të pranuar ndërkombëtarisht, si dhe në mbrojtjen e të drejtave dhe në pjesëmarrjen e të gjitha komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre"*.

Neni 23 [Dinjiteti i Njeriut]

*“Dinjiteti i njeriut është i pacenueshëm dhe është bazë e të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut”.*

Neni 24.1 [ Barazia para Ligjit]

*“Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim”.*

Neni 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit]

*“1. E drejta e punës garantohet. 2. Secili person është i lirë të zgjedhë profesionin dhe vendin e punës”.*

26. Përkitazi me këtë Gjykata thekson se parashtruesi vetëm ka potencuar shkeljen e këtyre dispozitave kushtetuese por nuk ka ofruar asnjë provë të vetme për mënyrën dhe natyrën e shkeljes, për rrethanat eventuale në të cilat shkelja e pretenduar ka ndodhur, nuk ka shpjeguar se cilat janë pasojat kushtetuese të shkeljeve eventuale të Kushtetutës.
27. Gjykata konsideron se, vetëm përshtkrimi i thjeshtë i dispozitave të Kushtetutës dhe pretendimi se ato janë shkelur, pa paraqitur fakte për mënyrën e shkeljes, pa përcaktuar rrethanat dhe pa specifikuar veprimet e autoritetit publik që bien në kundërshtim me normat kushtetuese nuk janë bazë e mjaftueshme për të bindur Gjykatën se ka pasur shkelje të Kushtetutës apo të KEDNJ .
28. Gjykata, duke bërë shqyrtimin e kërkesës së parashtruesit dhe të fakteve të paraqitura me kërkesë, gjen se në të gjitha fazat e procesit gjyqësor ankesat e parashtruesit kanë qenë të karakterit ligjor dhe asnjëherë e në asnjë fazë të natyrës kushtetuese apo të shkeljes eventuale të të drejtave të njeriut të mbrojtura me Kushtetutë, të cilat për herë të parë janë ngritur në Gjykatën Kushtetuese, gjë që gjykatën e shpien të konkludojë se në të vërtetë parashtruesi është i pakënaqur me rezultatin përfundimtar të gjykimit të rastit të tij.
29. Gjykata edhe më tutje thekson se nuk është gjykatë e faktit dhe nuk gjykon si gjykatë e instancës së katërt, dhe nuk është thjeshtë një instancë më tepër gjyqësore. Gjykata në parim nuk gjykon faktin nëse gjykatat e rregullta në mënyrë të drejtë dhe të plotë e kanë konstatuar gjendjen faktike apo të vërtetojë nëse punësimi i parashtruesit ishte ndërprerë në bazë ligjore apo joligjore, sepse kjo është kompetencë e gjykatës së rregullt. Për Gjykatën janë thelbësore çështjet prej ekzistimit të të cilave varet vlerësimi për shkelje eventuale të të drejtave kushtetuese, dhe jo çështjet qartazi ligjore që kryesisht kanë qenë fakte të paraqitura nga parashtruesi (shih, *mutatis mutandis*, i. a., *Akdivar kundër Turqisë*, 16 shtator 1996, R.J.D, 1996-IV, para. 65).
30. Gjykata rikujton se fakti i thjeshtë se parashtruesit janë të pakënaqur me rezultatin e rastit, nuk mund t’u shërbejë atyre si e drejtë për të parashtruar një kërkesë të argumentueshme për shkeljen e dispozitave të Kushtetutës (shih, *mutatis mutandis*, Aktgjykimi i GJEDNJ-së, kërkesa Nr. 5503/02, *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, ose Aktvendimin e Gjykatës Kushtetuese, rasti KI128/12, i 12 korrikut 2013, të parashtruesit *Shaban Hoxha*,



në kërkesën për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 316/2011).

31. Në këto rrethana, Gjykata konstaton se faktet e paraqitura nga parashtruesi në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e të drejtës për gjykim të drejtë e të paanshëm, andaj në përputhje me rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës mund të konstatohet se kërkesa është qartazi e pabazuar.

### **PËR KËTO ARSYE**

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe rregullat 36 dhe 56 (2) të Rregullores së punës, më 23 shtator 2014, njëzëri

### **VENDOS**

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Gjyqtari raportues**

  
Kadri Kryeziu



**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

  
Prof. dr. Enver Hasani